



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18/2023 (JR)  
Nr. 18/ 2 regj.

Tiranë më 19.06.2025

**SHPLLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e mërkurë, **datë 23.07.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 18/2023, datë 09.05.2023, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 630, datë 03.03.2023.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

|                                    |                        |
|------------------------------------|------------------------|
| <b>Kryesuese e Trupit Gjyqësor</b> | <b>Albana Shtylla</b>  |
| <b>Relator i Çështjes</b>          | <b>Sokol Çomo</b>      |
| <b>Gjyqtare</b>                    | <b>Natasha Mulaj</b>   |
| <b>Gjyqtare</b>                    | <b>Ina Rama</b>        |
| <b>Gjyqtare</b>                    | <b>Rezarta Schuetz</b> |

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARE**

**ALBANA SHTYLLA**

